



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1508 / Prot.
3

Tiranë, më 29 / 12 / 2016

REKOMANDIM

Nr. 39, datë 29 / 12 / 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "**Spitali Continental**", Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 267, datë 22.12.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "**Spitali Continental**", me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personi me initiale A.K, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe sensitive të të afërmit, të bëra publike në faqen zyrtare të kontrolluesit dhe në media, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;
- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i detyrimit për njoftim në kuadër të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga personi me initiale A.K i cili pretendonte se në spotin publicitar të spitalit, të publikuar në media dhe në faqen zyrtare në internet të kontrolluesit, shfaqen pamjet e të afërmit të tij pa marrë pëlqimin e këtij të fundit.

Pala ankuese ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentin shëndetësor për kryerjen e ekzaminimit në ambientet e kontrolluesit dhe foto të shkëputura nga spoti publicitar.

Kontrolluesi "**Spitali Continental**" ushtron aktivitet në fushën e shëndetësisë duke ofruar shërbime mjekësore të ndryshme dhe në këtë kuadër përpunon të dhëna personale/sensitive kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "pacientë" por edhe për "punonjësit". Kontrolluesi i përpunon të dhënat në mënyrë manuale nëpërmjet kartelave mjekësore të

pacientëve të cilat administrohen nga stafi mjekësor dhe në mënyrë elektronike nëpërmjet pajisjeve dhe programeve mjekësore.

1. Zyra e Komisionerit, në kuadër të trajtimit të ankesës, konstatoi se reklama e referuar në ankesë është përgatitur dhe publikuar në muajin Qershor 2016. Pas verifikimit të kryer, rezultoi se në atë fragment të reklamës paraqitet një zotëri tjetër që në fakt nuk është personi i pretenduar nga ankuesi por është i afërmi i znj. J. L (Menaxhere Operacionale e Spitalit) e cila asistoi grupin e hetimit administrativ gjatë inspektimit.

Ky konstatim u provua me paraqitjen fizikisht të zotërisë në fjalë në ambientet e spitalit, në prezencë të grupit të inspektimit dhe nga fotot e bëra ndaj tij. Gjithashtu nga ana e tij është nënshkruar një deklaratë ku sqaron se ka qenë pjesë e spotit publicitar (në sekuencën e pretenduar nga ankuesi) me pëlqimin e tij të shprehur dhe bashkëlidhur fotokopjen e pasaportës.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimi i palës ankuese nuk është i bazuar në prova dhe në fakte.

2. Kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale (pacientët), mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Në këtë kuadër, lind nevoja që në kontratat që kontrolluesi nënshkruan me pacientët dhe kartelat mjekësore të parashikohet detyrimi për informim në përputhje me nenin 18 të ligjit.

Gjithashtu, në faqen e internetit të kontrolluesit www.spitalcontinental.com nuk është i parashikuar informimi nëpërmjet rubrikës "*Politikat e privatësisë*". Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë "*Politikat e privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Reflektimi në kontratë i detyrimit për informim dhe publikimi i "*Politikave të privatësisë*" realizon qëllimin që ka neni 18 i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

3. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se nuk është përmbushur detyrimi për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet: "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji*".

Realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Në vijim kontrolluesi ka reaguar duke e realizuar menjëherë detyrimin për njoftim.

4. Kontrolluesi nuk ka hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të pacientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbalit i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi se personi të cilit i referohet ankuesi është i afërm i saj i cili ka lëshuar edhe një deklaratë pëlqimi të nënshkruar prej tij (administruar si provë). Gjithashtu ka deklaruar se janë një kontrollues i ri që ka filluar aktivitetet prej pak muajsh dhe që nuk ka patur dijeni për ligjin, por do të marrin angazhimin për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neni 31, pika 1, germa a/1,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të marren masa për të përfshirë në faqen e internetit në rubrikën “Politikat e Privatësisë”, informacionin sipas Opinionit të Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”, publikuar në faqen zyrtare www.idp.al. Detyrimi për informim të parashikohet edhe në formatin e kontratave që kontrolluesi nënshkruan me pacientët;
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të hartohet dhe miratohet “Rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale”, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave të pacientëve;

3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit;
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky rekomandim u shpall sot më datë 29.12 2016.

